2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial.....

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Nr	Emertimi Shërbimit	Model Printeri/Fotokopje	Sasia
1	Pastrim, Mirembajtje e përgjithshme	Canon IR Advanced C5550	6
2	Riparim Grupit Drum per Ngjyren e zeze	Canon IR Advanced C5550	6
3	Riparim grupit te ushqimit(PS)	Canon IR Advanced C5550	1
4	Riparim MotherBoard	Canon IR Advanced C5550	1
5	Pastrim, Mirembajtje e përgjithshme	Kyocera FS-6525MFP	8
6	Riparim/Ndryshim Gomina ADF Sirtar	Kyocera FS-6525MFP	8
7	Pastrim, Mirembajtje e përgjithshme	Xerox Workcentre 5335	1
8	Riparim Furre(Fuser Unit)Film,Press, etj	Xerox Workcentre 5335	1
9	Riparim Drum Unit Cilinder,Fshirese,Korone	Xerox Workcentre 5335	1

10	Riparim/Ndryshim Gomina ADF Sirtar	Xerox Workcentre 5335	1
11	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Sharp AR-6020	2
12	Riparim Drum Unit Cilinder,Fshirese,Korone	Sharp AR-6020	2
13	Riparim Furre(Fuser Unit)Film,Press, etj	Sharp AR-6020	2
14	Riparim/Ndryshim Gomina ADF	Sharp AR-6020	2
15	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Ricoh Afficio C3503	2
16	Riparim Drum Unit (Cilinder,Fshirese,Korone)4Color	Ricoh Afficio C3503	8
17	Riparim Furre(Fuser Unit)Film,Press, etj	Ricoh Afficio C3503	2
18	Riparim/Ndryshim Gomina ADF	Ricoh Afficio C3503	2
19	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Xerox Workcentre 5021	2
20	Riparim Drum Unit (Cilinder,Fshirese,Korone)	Xerox Workcentre 5021	2
21	Riparim Furre(Fuser Unit)Film,Press, etj	Xerox Workcentre 5021	2
22	Riparim/Ndryshim Gomina ADF	Xerox Workcentre 5021	2
23	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Sharp MX-2614	1
24	Riparim Drum Unit (Cilinder,Fshirese,Korone)4Color	Sharp MX-2614	4
25	Riparim Furre(Fuser Unit)Film,Press, etj	Sharp MX-2614	1

26	Riparim/Ndryshim Gomina ADF	Sharp MX-2614	1
27	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Xerox Versalink C7020	1
28	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	XEROX wc 7120/25	1
29	Riparim Drum Unit Cilinder,Fshirese,Korone(4Color)	XEROX wc 7120/25	4
30	Riparim Furre(Fuser Unit)Film,Press, etj	XEROX wc 7120/25	1
31	Riparim/Ndryshim Gomina ADF	XEROX wc 7120/25	1
32	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	HP Laser Color M476dn	1
33	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Samsung SCX-3400	1
34	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Lexmark MX310DN	12
35	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Hp LaserJet P3015	3
36	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	HP LaserJet Pro M1132	1
37	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Samsung ML-2010D	1
38	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Samsung Xpress SL-M2070	1
39	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Brother HL-6250DN	5
40	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Lexmark MS310D	6
41	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Ricoh MP201	2

42	Riparim Drum Unit Cilinder,Fshirese,Korone	Ricoh MP201	2
43	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Ricoh MP301	2
44	Riparim Drum Unit Cilinder,Fshirese,Korone	Ricoh MP301	2
45	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	HP Laser Color M477dn	1
46	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Brother MFC-L2752DW	3
47	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Hp LaserJet Pro MFP M28a	1
48	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Brother DCP-L2640DN	10
49	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Ricoh Mp402	4
50	Riparim Drum Unit Cilinder,Fshirese,Korone	Ricoh Mp402	3

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]
[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmblidhjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj: **Materiali me PDF**

Specifikimi i Materialeve: **Materiali me PDF**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: **Materiali me PDF**

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: 12 muaj

Afatet e ekzekutimit:

Nr	Emertimi Shërbimit	Model Printeri/Fotokopje	Sasia	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
1	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Canon IR Advanced C5550	6	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
2	Riparim Grupit Drum per Ngjyren e zeze	Canon IR Advanced C5550	6	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
3	Riparim grupit te ushqimit(PS)	Canon IR Advanced C5550	1	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
4	Riparim MotherBoard	Canon IR Advanced C5550	1	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
5	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Kyocera FS- 6525MFP	8	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
6	Riparim/Ndryshim Gomina ADF Sirtar	Kyocera FS- 6525MFP	8	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
7	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Xerox Workcentre 5335	1	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
8	Riparim Furre(Fuser Unit)Film,Press, etj	Xerox Workcentre 5335	1	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates

9	Riparim Drum Unit Cilinder,Fshirese,Korone	Xerox Workcentre 5335	1	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
10	Riparim/Ndryshim Gomina ADF Sirtar	Xerox Workcentre 5335	1	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
11	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Sharp AR-6020	2	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
12	Riparim Drum Unit Cilinder,Fshirese,Korone	Sharp AR-6020	2	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
13	Riparim Furre(Fuser Unit)Film,Press, etj	Sharp AR-6020	2	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
14	Riparim/Ndryshim Gomina ADF	Sharp AR-6020	2	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
15	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Ricoh Afficio C3503	2	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
16	Riparim Drum Unit (Cilinder,Fshirese,Korone)4Color	Ricoh Afficio C3503	8	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
17	Riparim Furre(Fuser Unit)Film,Press, etj	Ricoh Afficio C3503	2	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
18	Riparim/Ndryshim Gomina ADF	Ricoh Afficio C3503	2	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
19	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Xerox Workcentre 5021	2	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
20	Riparim Drum Unit (Cilinder,Fshirese,Korone)	Xerox Workcentre 5021	2	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
21	Riparim Furre(Fuser Unit)Film,Press, etj	Xerox Workcentre 5021	2	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
22	Riparim/Ndryshim Gomina ADF	Xerox Workcentre 5021	2	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
23	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Sharp MX-2614	1	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
24	Riparim Drum Unit (Cilinder,Fshirese,Korone)4Color	Sharp MX-2614	4	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates

25	Riparim Furre(Fuser Unit)Film,Press, etj	Sharp MX-2614	1	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
26	Riparim/Ndryshim Gomina ADF	Sharp MX-2614	1	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
27	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Xerox Versalink C7020	1	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
28	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	XEROX wc 7120/25	1	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
29	Riparim Drum Unit Cilinder,Fshirese,Korone(4Color)	XEROX wc 7120/25	4	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
30	Riparim Furre(Fuser Unit)Film,Press, etj	XEROX wc 7120/25	1	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
31	Riparim/Ndryshim Gomina ADF	XEROX wc 7120/25	1	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
32	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	HP Laser Color M476dn	1	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
33	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Samsung SCX-3400	1	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
34	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Lexmark MX310DN	12	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
35	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Hp LaserJet P3015	3	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
36	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	HP LaserJet Pro M1132	1	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
37	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Samsung ML-2010D	1	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
38	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Samsung Xpress SL-M2070	1	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
39	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Brother HL-6250DN	5	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates

40	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Lexmark MS310D	6	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
41	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Ricoh MP201	2	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
42	Riparim Drum Unit Cilinder,Fshirese,Korone	Ricoh MP201	2	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
43	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Ricoh MP301	2	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
44	Riparim Drum Unit Cilinder,Fshirese,Korone	Ricoh MP301	2	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
45	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	HP Laser Color M477dn	1	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
46	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Brother MFC-L2752DW	3	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
47	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Hp LaserJet Pro MFP M28a	1	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
48	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Brother DCP-L2640DN	10	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
49	Pastrim, Mirembajtje e pergjithshme	Ricoh Mp402	4	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
50	Riparim Drum Unit Cilinder,Fshirese,Korone	Ricoh Mp402	3	Sipas kerkesave te AK	Grafiku 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

HYRJE

Ky dokument përcakton shërbimet e mirëmbajtjes, riparimit dhe ndërhyrjeve teknike për pajisje të printimit, kopjimit dhe skanimit (printerë, fotokopje dhe pajisje multifunktionale). Shërbimet ofrohen për të garantuar funksionim të qëndrueshëm, cilësi të lartë pune dhe jetëgjatësi më të madhe të pajisjeve, në përputhje me standardet teknike dhe kërkesat e përdorimit institucional.

Ndërhyrjet përfshijnë pastrim dhe mirëmbajtje të përgjithshme, si dhe riparime specifike të komponentëve mekanikë dhe elektronikë, duke përdorur pjesë origjinale ose ekuivalente cilësore dhe staf teknik të kualifikuar.

QËLLIMI

Qëllimi i ofrimit të këtyre shërbimeve është:

- Të sigurojë funksionim normal dhe të pandërprerë të pajisjeve
- Të parandalojë defektet e papritura dhe ndalimet në punë
- Të ruajë dhe përmirësojë cilësinë e printimit, kopjimit dhe skanimit
- Të zgjasë jetëgjatësinë e komponentëve kryesorë (Drum Unit, Fuser, ADF, Paper Supply, Motherboard, etj.)
- Të reduktojë kostot afatgjata të mirëmbajtjes dhe zëvendësimit të pajisjeve
- Të ofrojë ndërhyrje profesionale, të sigurta dhe të dokumentuara për çdo shërbim të kryer

Shërbimet synojnë të përmbushin nevojat operative të klientit duke garantuar efikasitet, siguri dhe besueshmëri në përdorimin e pajisjeve të printimit.

SPECIFIKIME TEKNIKE

1. Pastrim dhe Mirëmbajtje e Përgjithshme

(Printer / Fotokopje / Multifunksional)

Çfarë është ky shërbim?

Ky shërbim përfshin kontrollin, pastrimin dhe mirëmbajtjen periodike të pajisjeve të printimit/kopjimit, me qëllim parandalimin e defekteve, ruajtjen e cilësisë së printimit dhe zgjatjen e jetës së pajisjes.

Çfarë përfshin konkretisht shërbimi?

Pastrim i jashtëm

- Pastrim i panelit të komandimit
- Pastrim i kapakëve dhe trupit të pajisjes
- Pastrim i tabakave të letrës dhe ADF

Pastrim i brendshëm

- Heqje e pluhurit dhe mbetjeve të tonerit
- Pastrim i rulave të letrës
- Pastrim i sensorëve dhe ventilatorëve
- Pastrim i pjesëve mekanike të aksesueshme

Kontroll teknik

- Kontroll i gjendjes së Drum Unit
- Kontroll i Fuser Unit (furra)
- Kontroll i gomave ushqyese
- Verifikim i kablllove dhe lidhjeve

Rregullime bazike

- Rregullim i ushqimit të letrës
- Kalibrim bazik i printimit/kopjimit
- Reset i mesazheve të mirëmbajtjes (nëse lejohet)

Testim final

-
- Test printimi/kopjimi
 - Test skanimi (për pajisjet multifunksionale)

Probleme që parandalohen

- Bllokime të shpeshta letre
- Vija dhe njolla në printim
- Zhurma gjatë punës
- Konsum i parakohshëm i pjesëve
- Defekte të papritura

Përfitimet për Institucionin e Bashkisë

- Funksionim i qëndrueshëm i pajisjes
- Cilësi më e mirë printimi
- Reduktim i kostove të riparimit
- Jetëgjatësi më e madhe e pajisjes

2. Riparim / Zëvendësim Motherboard

Pajisje: Canon iR ADVANCE C5550

Çfarë është Motherboard?

Motherboard (Main Board / Control Board) është pjesa kryesore elektronike e pajisjes, që kontrollon:

- ndezjen dhe funksionimin e printerit/fotokopjes
- komunikimin me kompjuterin dhe rrjetin
- menaxhimin e printimit, skanimit dhe kopjimit

Kur motherboard dëmtohet, pajisja mund të mos ndizet, të shfaqë gabime kritike ose të mos funksionojë fare.

Çfarë përfshin shërbimi i riparimit?

Diagnostikim Teknik

- Kontroll i plotë elektronik i motherboard-it
- Identifikim i defektit (qark i djegur, komponentë të dëmtuar, moskomunikim)
- Verifikim i kodeve të gabimit (error codes)

Riparim ose Zëvendësim

- Riparim i komponentëve elektronikë (nëse është e mundur)
ose
- Zëvendësim i motherboard-it me pjesë origjinale ose ekuivalente të certifikuar

Programim dhe Konfigurim

- Programim i motherboard-it sipas pajisjes
- Konfigurim i parametrave bazë të sistemit
- Sinkronizim me module të tjera (scanner, fuser, engine)

Montim dhe Testim

- Montim profesional në pajisje
- Testim i plotë funksional:
 - ndezje
 - printim
 - kopjim
 - skanim
 - lidhje rrjeti

Probleme që zgjidhen me këtë shërbim

Pajisja nuk ndizet

Gabime kritike në ekran

Nuk printon / nuk kopjon

Nuk lidhet me rrjetin

Ristartime të shpeshta ose bllokime

Përfitimet për Institucionin e Bashkisë

- Rikthim i plotë i funksionimit të pajisjes
- Zgjidhje profesionale pa zëvendësuar gjithë pajisjen
- Kursim i konsiderueshëm i kostos
- Siguri dhe stabilitet në përdorim

3. Riparimi ose ndërrimi i Grupit të Ushqimit (PS – Power Supply)

të pajisjes Canon imageRUNNER 5550, me qëllim rikthimin e funksionimit normal dhe të qëndrueshëm të pajisjes.

Përshkrimi i Shërbimit

Riparim i PS:

- Diagnostikim i defektit
- Zëvendësim i komponentëve të dëmtuar
- Testim funksional pas riparimit

Ndërrim i PS:

- Çmontim i PS ekzistuese
 - Vendosje e PS origjinale ose kompatibël të certifikuar
 - Testim funksional pas ndërrimit
-

3. Specifikime Teknike Minimale

- Input: AC 220–240 V, 50/60 Hz
 - Output:
 - +24 V DC
 - +12 V DC
 - +5 V DC
 - +3.3 V DC (nëse aplikohet)
 - Toleranca e tensionit: sipas standardeve të prodhuesit
-

4. Kërkesa për Pjesë dhe Materiale

- Përdorim i pjesëve origjinale ose të certifikuara kompatibël
 - Komponentë cilësorë, të rinj dhe të papërdorur
 - Ndalohet përdorimi i pjesëve inferiore ndaj specifikimeve origjinale
-

5. Testim dhe Pranim

- Pajisja duhet të ndizet dhe të funksionojë normalisht
- Nuk duhet të shfaqë kode gabimi
- Testim pune nën ngarkesë funksionale
- Konfirmim i stabilitetit gjatë përdorimit

4. Riparim Drum Unit (Cilindër, Fshirëse, Koronë) – 4 Color

Çfarë është ky shërbim?

Ky shërbim përfshin riparimin dhe rikondicionimin e Drum Unit për printerë/fotokopje me 4 ngjyra (CMYK: Cyan, Magenta, Yellow, Black), me qëllim rikthimin e cilësisë së printimit dhe funksionimit korrekt të pajisjes.

Çdo ngjyrë ka Drum Unit të veçantë, dhe shërbimi kryhet për të katër njësitë.

Çfarë përfshin konkretisht shërbimi?

Cilindri (OPC Drum)

- Kontrollohet gjendja e cilindrit për gërvishtje, konsum ose njolla
- Zëvendësohet nëse është i dëmtuar
- Siguron transferim të saktë të imazhit për secilën ngjyrë

Fshirësja (Cleaning Blade / Wiper Blade)

- Zëvendësohet ose rregullohet
- Pastron mbetjet e tonerit nga cilindri
- Parandalon vija, njolla dhe hije në faqe

Korona (Corona Wire / PCR Roller)

- Pastrohet ose zëvendësohet
 - Siguron ngarkesë elektrike të njëtrajtshme
 - Ndikon drejtpërdrejt në cilësinë dhe saktësinë e ngjyrave
-

Përfitimet për Institucionin e Bashkisë

- Cilësi e lartë printimi për të 4 ngjyrat
 - Eliminim i vijave, njollave dhe shtrembërimeve të ngjyrave
 - Jetëgjatësi më e madhe e Drum Unit
 - Kosto më e ulët krahasuar me zëvendësimin komplet të njësive
 - Funksionim stabil i pajisjes
-

Si realizohet shërbimi?

- Çmontim profesional i Drum Unit për secilën ngjyrë
- Pastrim i plotë nga toner dhe pluhur
- Riparim / zëvendësim i komponentëve (cilindër, fshirëse, koronë)
- Montim dhe kalibrim
- Testim final për secilën ngjyrë (CMYK)

5. Riparim Furre (Fuser Unit) – Film, Press, etj.

Çfarë është Fuser Unit (Furra)?

Fuser Unit është pjesa e printerit/fotokopjes që ngjit tonerin në letër përmes nxehtësisë dhe presionit. Nëse furra nuk funksionon siç duhet, printimi del i zbehtë, njollosur ose toneri nuk fiksohet në letër.

Çfarë përfshin shërbimi i riparimit?

1. Film (Fuser Film / Sleeve)

- Kontroll i konsumit, çarjeve ose ngjitjes së tonerit
- Zëvendësim i filmit të dëmtuar
- Siguron ngrohje uniforme dhe rrëshqitje të saktë të letrës

2. Press Roller (Ruli i Presionit)

- Kontroll i sipërfaqes për djegie, deformime ose konsum
- Zëvendësim ose rregullim sipas nevojës
- Siguron presion të njëtrajtshëm gjatë fiksimit të tonerit

3. Elementë të tjerë të Fuser-it

- Grease / lubrifikant termik (aplikim i ri)
 - Sensorë temperature (thermistor, thermostat)
 - Gearë dhe bushina mekanike
 - Pastrim i plotë nga mbetjet e tonerit dhe pluhuri
-

Si realizohet shërbimi?

- Çmontim profesional i Fuser Unit
- Diagnostikim i defektit

-
- Riparim ose zëvendësim i pjesëve (film, press roller, etj.)
 - Montim korrekt dhe testim termik
 - Testim printimi për cilësi dhe temperaturë
-

Probleme që zgjidhen me këtë shërbim

- Toneri nuk fiksohet në letër
 - Letra del e rrudhur ose e djegur
 - Njolla ose hije pas printimit
 - Zhurma gjatë printimit
 - Gabime temperature (error fuser)
-

Përfitimet për Institucionin e Bashkisë

- Rikthim i cilësisë së printimit
- Jetëgjatësi më e madhe e Fuser Unit
- Kosto më e ulët krahasuar me zëvendësimin komplet
- Funksionim stabil i pajisjes

6. Riparim / Ndryshim Gomina ADF (Automatic Document Feeder)

Çfarë është ADF?

ADF (Automatic Document Feeder) është mekanizmi i printerit/fotokopjes që mundëson futjen automatike të dokumenteve për skanim ose kopjim. Gomina (rulat e gomës) janë pjesët kryesore që tërheqin letrën një nga një.

Kur gominat konsumohen, ADF nuk ushqen siç duhet dokumentet.

Çfarë përfshin shërbimi?

1. Diagnostikim

- Kontroll i gjendjes së gomave ushqyese

- Identifikim i rrëshqitjes, konsumit ose fortësimit të gomës

2. Riparim / Ndryshim Gomina

- Zëvendësim i gomave ushqyese ADF (Pickup Roller, Feed Roller, Separation Roller)
- Përdorim i gomave origjinale ose ekuivalente cilësore
- Pastrim i sipërfaqeve përreth nga pluhuri dhe mbetjet e letrës

3. Rregullim dhe Kalibrim

- Rregullim i presionit të rulave
- Kontroll i sensorëve të letrës
- Kalibrim i mekanizmit ADF

4. Testim Final

- Test ushqimi me disa faqe
- Verifikim që dokumentet të futen një nga një, pa bllokime ose dyfishime

Probleme që zgjidhen me këtë shërbim

- Nuk fut letrën në ADF
- Fut disa faqe njëherësh
- Bllokime të shpeshta letre
- Rrëshqitje e dokumenteve
- Zhurmë gjatë skanimit/kopjimit

Përfitimet për Institucionin e Bashkisë

Funksionim i saktë dhe i qëndrueshëm i ADF

Skanim/kopjim më i shpejtë

Mbrojtje e dokumenteve nga grisja

Kosto më e ulët se zëvendësimi i gjithë ADF

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

-
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% e vlerës së fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit financiare (2022, 2023, 2024) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit.

Shenim: Në respektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse dy bilancet e njepasnjeshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. (Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me aktekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar).

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2025, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë

30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2025. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar I grupit duhet të dorëzojë vërtetimin e lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB). Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me paraqitjen e nje deklarate. Bazuar nëpërcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, Për përvoja të mëparshme të realizuar me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohe vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar ne organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**”.

2.3.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001:2015 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (të vlefshme) dhe ISO 27001:2022 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit (e vlefshme).

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë një numër prej mesatarisht 3 (tre) punonjës të siguruar 3 (tre) muajt e fundit, si dhe gjatë vlefshmërisë së kontratës, ku përfshihet një personel teknik i diplomuar në degët e Inxhinierive Informatike (IT) që do të angazhohen në implementimin e mirëmbajtjes, si më poshtë:

a. 3 (tre) specialistë të certifikuar nga ITIL për menaxhimin e shërbimeve të IT, ose ekuivalent

Për të vërtetuar stafin e mësipërm operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Deklaratë për disponimin e punonjësve të përmendur në këtë pikë

-
- Certifikata përkatëse/ Transkriptet përkatëse
 - Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi.
 - Kontrata pune, për secilin nga punonjësit e përmendur në këtë pikë, të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

